



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "D&T Group" Sh.P.K. të datës 14.06.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 10.06.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit" me nr. të prokurimit 616-23-7016-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "D&T Group" Sh.P.K. e datës 14.06.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 10.06.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit" me nr. të prokurimit 616-23-7016-1-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** të gjitha palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "D&T Group" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 14.06.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 10.06.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit" me nr. të prokurimit 616-23-7016-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimet ankimore të parashtruesit:**

**P.1.**-"OE i rekomanduar per kontrate eshte i pa përgjegjshem pasi qe nuk permbush kerkesen e dosjes se tenderit te lartecukur te cilin pretendim edhe ju si AK e keni vertetuar ne B58 te dates 27.10.2023 qe kontratat e dorezuara me referenca nuk arrijne vleren e kerkuar prej 2,000.000.00€".

**P.2.**-"Ne dosjen e tenderit perkatesisht tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe professional keni kerkuar qe 2.- OE duhet te dorezoj nje autorizim nga prodhuesit të mjetit bazë (ose përfaqësuesit të autorizuar) dhe si deshmi 2.Dëshmia Autorizimi i lëshuar nga prodhuesi për mjetin bazë me numër të prokurimit publik për këtë procedurë. Pra duke u bazuar ne keto qe u thane me larte te cilat lehtesisht vertetohen ne dokumentet e dorezuara nga Vibtis dega ne Kosove, konstatojme se as kjo kerkese e dosjes se tenderit aspak nuk eshte permbushur dhe OE I rekomanduar per kontrate nuk ka autorizim te vlefshem per mjetin baze - shasine , per pjesemarrje ne kete procedur te prokurimit dhe eshte i papergjegjshem".

**P.3.**-"OE I rekomanduar per kontrate per kete kerkese ka prezantuar dokumentin e titulluar Declaration Saldatoret te leshuar nga shoqeria KARBA OTOMOTIV ku shihet qarte se eshte ne mosperputhje me kerkesen e autoritetit kontraktues. OE I rekomanduar per kontrate nuk ka ofruar deshmi punesimi kontrate per marredhenie te punes ose marreveshje per angazhin ne pune por vetem nje deklarate nga KARBA OTOMOTIV ku edhe kjo deklarate ne vete ka mosperputhje pasi qe vete KARBA OTOMOTIV deklarone qe ka te punesuar Abudall Satçelik, Hasan Akbulut, Mustafa Uçbas dhe Sefa Durmaz kurse ne liste e cila I eshte bashkangjitur kesaj deklarate eshte I permendur edhe emri Muhittin OZBEK qe per te cilin nuk as vete KARBA OTOMOTIV ne deklaraten e tij nuk e permend dhe askund ne kete deklarate nuk mund te gjinden nenshkrimet e te personave te cekur si saldator te certifikuar dhe te punesuar dhe as nuk mund te vertetohet qe keta persona jane apo vazhdojne te jene ne marredhenie pune me punedhenesin. Edhe ne kete pike deshmohet se OE I rekomanduar per kontrate eshte totalisht i papergjegjshem".

**P.4.**-"OE I rekomanduar per kontrate nuk ka permbushur plotesisht kerkesen nr.13 tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe professional pasi qe ka derguar vetem katalogun e shasise te nenshkruar dhe vulosur, kurse per superstruktura ka dorezuar nje PROFORMA INVOICE, 25.08.2023 -- 0498R1 e cila edhe nese nga ana juaj mund te konsiderohet si katalog nuk eshte I vulosur dhe I nenshkruar sipas kerkeses se dosjes se tenderit".

**P.5.**-"Ne dosjen e tenderit perkatesisht tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe professional keni kerkuar qe 14.OE duhet te ofroj Garancion për shasi dhe mbindërtim minimum 1 vit dhe si deshmi 14.Kopje e Garancionit per 1 vit për shasi dhe mbindërtim. OE I rekomanduar per kontrate aspak nuk permbush kete kerkese te dosjes se tenderit per arsye se: \* nuk ka dorezuar deklaraten e garancionit ne cilesine e OE as per shasi dhe as per superstruktura \* me deklaraten e garancionit nga KARBA OTOMOTIV qe perfshin vetem pjesen e superstruktures, KARBA deklarone qe superstruktura e kamioneve do te kete garancion 1 vit pas testimeve ne fabrike nga prodhuesi para dorezimit te perdoruesi I fundit - AK. Kjo deklarate nuk permbush obligimet e garancionit qe jane 1 vit pas dorezimit te mallrave dhe pranimit teknik te tyre. \* te garancioni I shasise Renault ka dorezuar nje broshure te garancionit dhe jo deklarate apo garancion per shasite e ofruara nga distributori I autorizuar. \* askund nuk eshte permendur procedura e prokurimit, nr I prokurimit apo titulli Pra lehtesisht mund te konstatohet dhe vertetohet qe OE I rekomanduar per kontrate eshte I papergjegjshem edhe per kete kerkese".

**P.6.**-"Tek Aneksi 1 është kërkuar që peshu brutto e shasisë së automjetit 16m<sup>3</sup> të jetë maksimumi 18 ton. Ndërsa vetë ofertuesi në dosjen "Specifikat & Katalog Renault", me deklaraten nga

distributori i Renault, Ceyhan Automotiv, ka cekur në përshkrimin teknik dhe në katalogun e tij se pesha e automjetit tejkalon peshën e përcaktuar maksimale nga autoriteti kontraktues, që në këtë rast është deklaruar si 20.1 ton, gjë që nuk është në përputhje me kërkesën e AK-së. Fuqia e motorit e kërkuar nga AK: minimumi 250 HP, ndërsa ofertuesi e ofron me 246 HP, që nuk përmbush minimumin e kërkesës nga AK. Për furnizimin me kamion për mbeturina me 8m është kërkuar që pesha bruto e automjetit të jetë maksimumi 10 ton. Ndërsa ofertuesi e ofron me peshë bruto 11.6 ton, gjë që nuk është në përputhje me kërkesat e AK-së. Tek superstruktura është kërkuar kuti kontrolli të papërshkueshëni nga uji, me nibrojtje IP 67, ndërsa karba mbindërtuesi e ofron me IP 65, gjë që nuk është në përputhje me kërkesat e AK-së”.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

OE Grup i Operatorëve Ekonomik D & T Group SH.P.K.; KOSOVA MOTORS J.S.C.: ne baze te Vendimit te OSHP-se nr. 2023/0906 dhe Vendimit 2023/908, te datës 25.01.2024, eshte i papërgjegjshëm. Gjithashtu, i ka skaduar vlefshmeria e sigurimit te tenderit . E kemi njoftuar dhe kemi kerkuar permes e-mailit zyrtar per ta vazhduar vlefshmerine e sigurimit te tenderit , mirepo nuk eshte pergjegjur ne kerkesen tone. Andaj komisioni vlereson se eshte e papërgjegjshme.

*Tenderi i juaj Kërkesa e juaj për pjesëmarrje është administrativisht e papërgjegjshme.*

Duhet cekur se parashtruesi nuk e ka vazhduar fare validitetin e ofertës që është kusht administrativ dhe oferta si e tillë është e papërgjegjshme. Sa i përket pretendimeve ankimore të parashtruesit duhet theksuar faktin se të gjitha pretendimet janë të drejtuara kundër tenderuesit të rekomanduar për kontratë pavarësisht faktit vet parashtruesi është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm me arsyetimin e cituar si më sipër. Duhet sqaruar se parashtruesi përderisa vet ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të dëshmoj asnjë interes të vetëm material nga cilido rezultat i aktivitetit të prokurimit në raport me këto pretendime të tij ankimore të drejtuara kundër tenderuesve të tjerë. Përmes nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP përcaktohet se “Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”. Nga këndvështrimi i kësaj dispozite të LPP, përderisa parashtruesi për vete ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, dhe nuk ka arritur që të dëshmoj të kundërtën as me këtë kërkesë për rishqyrtim, atëherë i njëjti nuk është palë e interesuar në raport me pretendimet e tij ankimore kundër tenderuesve të tjerë. Megjithatë duhet cekur se tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë tërësisht të përgjegjshme. Në fakt oferta e tenderuesit të rekomanduar është ofertë e përgjegjshme me çmimin më të lirë në përputhje të plotë me kriterin e dhënies sipas DT. Prandaj rekomandimi për dhënie të kontratës nga komisioni vlerësues është në përputhje të plotë me kriteret e dhënies së kontratës sipas dosjes së tenderit. Me fjalë të tjera, edhe po të ishte palë e interesuar parashtruesi në raport me këto pretendime, sërish pretendimet e tij janë në tërësi të pabazuara.


Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 24.06.2024**



Udhëheqës, Seksionit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.